



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.114/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në P., kundër debitorit NTPSH "R. "me seli në M., me bazë juridike borxh në bazë të titullit ekzekutiv, duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, përkritazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm , ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit, për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 2,515.20 €, ndërsa, kjo gjykatë me aktvendimin CP.nr.337/2013, të datës 15.09.2023, është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, dhe lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë departamentit për Çështje ekonomike.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e vet, KPPP.nr. 116/2024, të datës 09.02.2024, të korrigjuar më datën 21.02.2024, ka hapur konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke konsideruar se nuk kemi të bëjmë me kompetencë të Gjykatës Komerciale por kemi të bëjmë me përmbartimin e dokumentit në lejin e të cilit janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e lejuara., gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore Mitrovicë.

Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Me vështrim në nenin 13 pika 1.1. të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, parashihet se përveç tjerash "Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv vetëm në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare dhe kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore dhe për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se duke u bazuar në faktin se palë në procedurë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe objekt i kontestit është pagesa e borxhit, nga ky aspekt kontesti nuk ka të bëjë me afarizmin e ndërsjellët dhe nuk i përmbush kriteret në përputhje me Ligjin për Gjykatat lidhur me nenin 43 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas padisë se paditësve është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, në pajtim me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për gjykatat, i cili parasheh se "Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe". Prandaj për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm. Prandaj për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

CN.nr.114/2024 datë 07.03.2024

Kryetari i kolegjit,  
Beshir Islami